REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 5.10.2021

RAPORT

PËR AKTIN NORMATIV NR. 29, DATË 13.09.2021 "PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021"

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përrgjegjës, në mbledhjen e datës 5.10.2021 mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 29, datë 13.09.2021 "Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, caktoi relatore për shqyrtimin e aktit normativ deputeten Ermonela Felaj dhe deputetin Toni Gogu.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar aktin normativ ishin përfaqësues nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I. BAZA KUSHTETUESE PËR PROPOZIMIN E AKTIT NORMATIV

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT NORMATIV

Qëllimi

Qëllimi i këtij akti normativ është miratimi i tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen e miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021, "Për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik".

Këto ndryshime konsistojnë në rishikimin e termave të marrëveshjes ekzistuese, me synim shtimin e sasisë së dozave të kësaj vaksine, pa u ndryshuar elementët themelor si çmimi dhe kushtet e lëvrimit.

Përmbajtja e aktit normativ.

Akti normativ përbëhet nga 3 nene gjithsej.

- Në nenin 1, të aktit normativ parashikohet, miratimi i tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021.

- Në nenin 2, të aktit normativ parashikohen ruajtja e sekretit tregtar dhe mos publikimin e marrëveshjes në website të institucioneve dhe në Fletoren Zyrtare, si dhe sanksionon detyrimin e organeve shteterore për ruajtjen e konfidencialitetit. Marrëveshja siguron të njëjtin trajtim financiar, përjashtimin nga detyrimet që duhen paguar, siç përcaktohet në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021.

- Në nenin 3 të aktit normativ, parashikohet hyrja menjëherë në fuqi e tij dhe botimi në Fletoren Zyrtare.

III. VLERËSIMI I KUSHTETUTESHMËRISË SË AKTIT NORMATIV

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Akti normativ me fuqinë e ligjit është një instrument që ka për qëllim përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin.

Nevoja dhe urgjenca janë elemente përcaktuese të kushtetueshmërisë së aktit normativ. Sipas jurisprudencës kushtetuese, nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen, rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmenden fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata ***është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publikë ose për të drejtat themelore të shtetasve.*** Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot.

Akti Normativ që po shqyrtojmë vlerësohet se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, që diktohet nga nevoja për ndryshime të aktit të mëparshëm.

Kjo nismë ligjore e Qeverisë, ndërmerret në kushtet e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe kur Organizata Botërore e Shëndetësisë ka deklaruar pandemi, për shkak të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në mbarë globin.

Aktualisht vendi ynë dhe mbarë bota po përballen ndër të tjera edhe me variacione të shumta të Sars-Covid 19, fakt ky që ka shtuar ndjeshëm së fundmi shifrat e të infektuarve, të shtruarve në spitale por edhe të viktimave. Bazuar në këtë situatë epidemiologjike në vend, Komiteti Teknik i Eksperteve ka vendosur të lërë në fuqi masat aktuale, duke nënvizuar rëndësinë e vaksinimit masiv të popullatës.

Pikërisht kjo situatë e evidentuar më lart, ka sjellë "nevojën" dhe "urgjencën" për ndërhyrje të menjëhershme nga ana e Qeverisë, të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe të menjëhershëm për të mundësuar nevojën absolute dhe të menjëhershme për të siguruar vaksinën anti covid 19 dhe për vaksinimin e popullatës në një kohë sa më të shkurtër, për të kufizuar apo tejkaluar pandeminë covid 19, për të ulur mortalitetin dhe numrin e rasteve të rënda në spitale. Këto masa urgjente janë tregues që nuk kanë nevojë për tu analizuar më tej, për të provuar se ndodhemi përpara kushteve të nevojës dhe urgjencës dhe për rrjedhojë edhe të plotësimit të gjitha kushtëzimeve të nenit 101 të Kushtetutës.

Shtimi i numrit të vaksinave, ishte dhe mbetet një oportunitet që duhej shfrytëzuar në mënyrë të menjëhershme duke njohur faktin se kërkesat për vaksina drejt kompanisë prodhuese dhe furnizuese Pfizer Export B.V. nga e gjithë bota janë tepër të larta.

Në këto kushte, edhe përmbyllja sa më e shpejtë e procedurave të brendshme të miratimit, përben një avantazh absolut në sigurimin e këtyre dozave shtesë.

IV. EFEKTET FINANCIARE

Ky akt normativ ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, në masën 6 009 120 USD, të cilat do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

V. SHQYRTIMI I AKTIT NORMATIV NË KOMISION.

Gjatë prezantimit të aktit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u shpreh se përmes këtij akti normativ, mundësohen disa ndryshime në marrëveshjen e parë me Kompaninë Pfizer përmes së cilës sigurohen plus 500, 970 doza vaksina me afat lëvrimi brenda këtij viti dhe aktualisht nga . Qeveria është kryer pagesa edhe e shumës përkatëse, në vlerën 6 milionë USD. Marrëvëshja nuk ndryshon cmimin dhe kushtet e tjera të kontratës.

Me këtë marrëveshje sigurohet rritja e mbulesës së vaksinimit të popullatës, e cila përkon me planin kombëtar të vaksinimit, të miratuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, dhe Komiteti Kombëtar i Imunizimit dhe ai i ekspertëve të vaksinimit, të cilët kanë parashikuar vaksinimin e popullatës target brenda pranverës së vitit të ardhshëm.

Në janar 2021 me Kompaninë Pfizer, u siguruan 500,000 vaksinat e para, ndërkohë që kemi mundësuar edhe marrëveshje me distributorin e autorizuar të Sinovac, duke siguruar 1 milionë vaksina, marrëveshje për sigurimin e 50,000 dozave të vaksinës Sputnik 5 si dhe marrëveshje përmes instrumentit COVAX, i cili përgjatë një periudhe 1 vjeçare na siguron 1,140,000 doza vaksinash.

Aktualisht kemi siguruar mbi 2 milionë doza vaksinash nga të cilat, më shumë se 1.7 milion doza janë administruar, dhe kemi të garantuar vaksinimin në vazhdim jo vetëm të popullatës së riskuar, por edhe të të gjithë popullatës mbi 18 vjeç, që është popullata target e vendosur nga Komiteti i Ekspertëve. Mbi 900 mijë qytetarë janë vaksinuar me një dozë vaksine dhe mbi 800 mijë qytetarë janë vaksinuar me dy doza.

Deri në dhjetor 202,1 priten 1 milion doza vaksine, përpos të cilave presim nga instrumenti COVAX rreth 400 mijë vaksina si dhe presim donacione falë mbështetjes së disa vendeve të BE-së.

Për të siguruar vijimin e planit kombatar të vaksinimit dhe për të rritur mbulesën vaksinale për vitin 2022 jemi në negociata për një marrëveshje të re me kompaninë Pfizer.

Relatorja e Komisionit, u shpreh se akti normativ i propozuar nga Këshilli i Ministrave, ndërmerret në kushtet kur Shqipëria ashtu si të gjitha vendet në mbarë botën prej një kohe të gjatë tashme është prekur nga pandemia e covid 19. Në këtë kuadër, sfida më e madhe për çdo qeveri është dhe mbetet vaksinimi i popullatës, çfarë do të mundësonte, reduktim të mortalitetit dhe të rasteve të rënda të shtrimit në spital të popullatës së prekur, krijimin e imunitetit të turmës, reduktimin deri në eliminimin e pandemisë.

Sfida e vaksinimit të popullatës, bëhet akoma edhe më evidente në kushtet kur variacione të shumta të Sars-Covid 19, tashmë janë në qarkullim, përfshirë edhe Shqipërinë, fakt ky që ka shtuar së fundmi shifrat e të infektuarve, të shtruarve në spitale.

Aktualisht Shqipëria përmes mekanizmit Covax si dhe përmes negocimit direkt me prodhuesit dhe furnizuesit, ka mundësuar funizimin me vaksina Phizer dhe Astrazeneca, vaksina këto që kanë marrë një aprovim për përdorim në popullatë nga EMA dhe FDA. Gjithashtu Shqipëria ka miratuar përdorimin dhe ka siguruar një sasi të konsiderueshme vaksinash edhe nga trupa te tjera certifikuese të vendeve që prodhojnë vaksinën, konkretisht me vaksinën Coronavac e prodhuar nga Sinovac Life Sciences Ltd, e aprovuar edhe nga OBSH-ja dhe vaksinën Sputnik V, e prodhuar nga Instituti Gamalieva në Federaten Ruse.

Në kuadër të të gjitha masave dhe përpjekjeve të Qeverisë për reduktim të pasojave të pandemisë, për të shmangur hezitimin e popullatës lidhur me llojin e vaksinës që duhet të bëjnë dhe për të stimuluar kësisoj shtimin e personave të vaksinuar si dhe për të krijuar një mundësi të barabartë për të gjithë qytetarët, muajt gusht dhe shtator të këtij viti, kanë qënë muaj të hapur ku çdo qytetar ka patur të drejtën të zgjedhë vaksinën që dëshiron të bëjë.

Sa më sipër, për të mundësuar plotësimin/mundësimin e marrjes së dozës së dytë të vaksinimit, por edhe për të vijuar vaksinimin e mëtejshëm të popullatës, grupi i punës së ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kryer një seri negociatash me Kompaninë prodhuese dhe furnizuese Pfizer Export B.V., për të mundësuar shtimin e numrit të dozave të vaksinave në favor të Shqipërisë, përtej sasisë së miratuar përmes aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 3 datë 18.01.2021, pa ndryshuar elementë të rëndësishëm të saj si çmimin apo kushtet e lëvrimit.
Theksojmë gjithashtu faktin se marrëveshja ndryshuese është konfidenciale dhe ky ka qenë një nga kushtet e panegociueshme me kompaninë Pfizer Export B.V.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit, pra mospublikimin e marrëveshjes për shkak të sekretit tregtar, është përcaktuar dhe rregulluar në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021, dhe është në fuqi edhe për tekstin e marrëveshjes së nënshkruar.

Më pas, anëtarët e komisionit i drejtuan ministres një seri pyetjesh që konsistuan kryesisht:

- Në dhënien e një informacioni statistikorë lidhur me nivelin e vaksinimeve dhe kur synohet vaksinimi i popullsisë target dhe disponibilitetin e vaksinave;
- Mundësimin ose jo të kryerjes së dozës së tretë të vaksinës për disa kategori të popullatës;
- Nëse mundësohet zinxhirit të vaksinimit edhe në rrethe duke respektuar sigurinë e ruajtjes së tyre; etj
- Nëse ka apo do ketë vendimmarrje lidhur me vaksinimin e detyrueshëm.
- Përqindja e rasteve të popullatës të shtruar në spitale që janë të vaksinuar.

Ministria informoi komisionin se aktualisht përqindja e popullatës së vaksinuar me 1 dozë është 44 %, ndërsa përqindja e popullatës së vaksinuar me 2 doza është 36 % ose rreth 790 mijë qytetarë, ndërkohë që synimi është vaksinimi i të gjithë qytetarëve. Kjo përqindje është dinamike dhe ndryshon në varësi të situatës, dhe sqaroi se që prej disa muajsh Shqipëria ka qënë e hapur për shkak të situtës të mirë me shifrat.

Ndërkohë, Ministria informoi komisionin se, targeti i popullatës për vaksinim sipas vlerësimeve që ka bërë Komiteti Teknik mbi popullatën mbi 18 vjeç, është 2 170 000 banorë, cfarë do të thotë se totali i dozave te nevojshme për mbulimin e kësaj popullate target me 2 doza është rreth 4.4 milionë doza vaksina. Ky target synojmë të arrihet brenda pranverës së vitit 2022.

Në rast se popullata target do të ndryshojë bazuar në vendimin e Komitetit të Ekspertëve, sigurisht do të ndryshojë edhe përqindja e mbulesës vaksinale. Synimi ynë është vijimi i lidhjeve të marrëveshjeve të mëtejshme, për të siguruar marrjen e dozave të vaksinave jo vetëm për popullatën target, por edhe për ti paraprirë edhe planeve, të cilat vijnë si rekomandim i Komitetit të Ekspertëve, në kuadër të Planit Kombëtar të Vaksinimit. Ministria theksoi se OBSH ka vendosur si target për të gjitha vendet që brenda vitit 2021 duhet të mbulojë 40% të popullatës dhe deri në qershor të vitit 2022, duhet të mbulohet 70% e popullatës.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale konfirmoi, disponibilitet të vaksinave, falë përpjekjeve të qeverisë shqiptare dhe garantoi që qytetarëve shqiptarë nuk do t'i mungojnë vaksinat, jo vetëm për popullatën target (popullsia plus 18 vjeç), por gjithashtu edhe nëse do të nevojitet doza e tretë e vaksinës dhe këtë e vendos Komiteti i Ekspertëve. Qeveria mbetet e gatshme t'i përgjigjet financiarisht edhe në disponibilitet vaksinash dozave të treta, por edhe nëse vendosin për t'u vaksinuar sa më shpejt kategoria e fëmijëve.

Ministria informoi komisionin se aktualisht është siguruar zinxhiri furnizimit të sigurte të vaksinave, mbikëqyrje kjo që bëhet nga Instituti i Shëndetit Publik deri në pikat fundore të mbërritjes së vaksinave.

Për sa i përket vaksinimit të detyruar, Komiteti i Ekspertëve të Vaksinimit ka rekomanduar vaksinimin e detyruar për personelin mjekësor, mësuesit dhe pedagogët në shkolla e universitete, vaksinimin e detyruar për studentët 18- 25 vjeç që frekuentojnë universitetin.

Komiteti i Ekspertëve është duke vlerësuar kategoritë e tjera për vaksinimin e detyruar si: administratën publike si dhe të gjithë punonjësit e shërbimeve. Ne jemi duke vlerësuar se si do të shtrijmë në mënyrë të mëtejshme vaksinimin edhe për kategori të tjera. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është nxitëse në këtë proces, për të marrë vendime bazuar në rekomandimet e ekspertëve, të cilët deri sot na kanë treguar që na kanë sjellë rezultate shumë pozitive për sa i përket pandemisë.

Ndërkohë lidhur me numrin e rasteve të shtrimeve në spitale, informoi se qytetarët e shtruar janë kryesisht të pavaksinuar në rreth 95% e tyre.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar se Akti normativ nr. 29, datë 13.09.2021 "Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021", plotëson elementin e nevojës dhe urgjencës, si dhe duke vlerësuar se propozimi formal si dhe përmbajtja e Aktit Normativ është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, e miratoi atë me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

R E L A T O R **RELATOR**

ERMONELA FELAJ **TONI GOGU**

KRYETARE

KLOTILDA BUSHKA